

Emri i pacientit: .....

Datëlindja: .....

### **E nderuar paciente! I nderuar pacient!**

Ju jeni rekomanduar nga mjekja/mjeku juaj të kryeni një ekzaminim tomografik kompjuterik (TK). Për informacionin tuaj, ne ju kërkojmë mirësisht, që ta lexoni këtë tekst dhe t'ju përgjigjeni pyetjeve në faqen 2. Në kuadrin e një bisede shpjeguese ju do të sqaroheni mbi të gjitha faktet e rëndësishme dhe do të keni mundësinë të drejtoni pyetjet tuaja.

### **Çfarë është tomografia kompjuterike?**

Tomografia kompjuterike (TK) është një ekzaminim veçantë me rreze X, me ndihmën e të cilit përfitohen imazhe të prerjes tërthore të trupit. Në këtë mënyrë, mund të përfitohen informacione mbi situatën dhe vatrën e sëmundjes. Shpesh, kjo është shumë e rëndësishme për trajtimin e mëtejshëm.

### **Si kryhet ekzaminimi?**

Ekzaminimi zgjat rreth 10-15 minuta. Gjatë ekzaminimit ju jeni i/e shtrirë në një tryezë të veçantë ekzaminimi, e cila lëviz përmes hapjes së pajisjes së tomografisë kompjuterike. Gjatë gjithë kohës së ekzaminimit, ju jeni nën mbikëqyrjen e personelit të specializuar dhe i lidhur me të nëpërmjet një sistemi komunikimi.

### **Çfarë duhet të bëj?**

Për të arritur një cilësi optimale të imazheve, ne ju lutemi që të rrini i/e shtrirë dhe qetësisht përgjatë gjithë ekzaminimit. Gjatë disa ekzaminimeve ne mund t'ju kërkojmë të ndiqni disa nga udhëzimet tona (p.sh.: merrni frymë, nxirreni frymën, mbajeni frymën, mos u kapërdini etj.).

### **Rreziku i rrezeve X:**

Në raste shumë të rralla dozimi i lartë i rrezeve X mund të shkaktoj krijimin e tumoreve. Përgjithësisht ky rrezik është shumë i ulët tek rrezet e përdorura nga tomografia kompjuterike dhe varet nga mënyra dhe numri ekzaminimeve të kryera me rreze X. Ju jeni rekomanduar të kryeni këtë ekzaminim TK nga mjekja/ mjeku juaj, sepse ky ekzaminim është i rëndësishëm për diagnostikimin, informacionin nuk mund të përfitohet nga një ekzaminim tjetër.

Për të vlerësuar rrezikun tuaj individual ndaj efektet anësore të padëshiruara, ju lutemi mirësisht, që t'ju

përgjigjeni pyetjeve të listuara në faqen e pasme duke vendosur një kryq.

Në rast paqartësie, punonjësit tanë të shërbimit teknik mjekësor (MTD) apo mjeket dhe mjekët tanë, j'u vijnë në ndihmë me kënaqësi.

### **Përse duhet lënda e kontrastit?**

Lënda e kontrastit mund të jetë vendimtare për vlefshmërinë e shumë ekzaminimeve TK dhe u vjen në ndihmë mjekëve dhe mjekëve të njohin më mirë ndryshimet patologjike. Lënda e kontrastit jepet gjatë ekzaminimit në formë infuzioni në venën e krahut.

### **Mund të ketë ndërlikime?**

Në vendin e shpimit të gjilpërës - si çdo injeksion - mund shkaktohet dhimbje, rrjedhje gjaku dhe shumë rrallë infeksion. Shumë njerëz gjatë përdorimit kanë një ndjesi të ngrohtë në trup dhe shije të hidhur në gojë. Studime shkencore tregojnë, se më tepër se 99% e pacienteve dhe pacientëve e tolerojnë lëndën e kontrastit të përdorur. Rrallë (rreth 1 në 400) ndodh ulje e lehtë tensionit të gjakut dhe për pasojë simptoma të lehta të përziera dhe dhimbje. Shumë rrallë (rreth 1 në 10.000) ka veprime anësore të rënda si marrje fryme, rëzë e tensionit të gjakut, çrregullimi të ritmit të zemrës apo kriza. Si pothuajse në të gjitha ndërhyrjet mjekësore, ekziston rreziku i një komplikacioni kërcënues për jetë, megjithatë jashtëzakonisht i rrallë.

Nëse tek ju do të shfaqeshin veprime anësore, ndihma e menjëhershme mjekësore është në çdo kohë në dispozicionin tuaj.

Rrallë mund të ndodh, që të ketë rrjedhje të lëndës së kontrastit nga vendi i injeksionit në krahë. Kjo çon në ënjtje të dhimbshme, e cila mund të zgjas disa ditë me radhë dhe mund të kërkojë trajtim. Në rast se ju ndjeni dhimbje apo ënjtje të krahut gjatë ekzaminimit, ju lutemi të informoni menjëherë - edhe gjatë ekzaminimit - stafin profesional teknik mjekësor, i cili është duke kryer ekzaminimit.

## BROSHURË INFORMUESE Tomografia kompjuterike (TK)

**1. Gjatësia (cm):** ..... **Pesha (kg):** .....

**2. Për gratë:**  
Ekziston mundësia të jeni shtatzënë?  Jo  Po .....

**3. A e keni kryer më parë këtë ekzaminim?**

Tomografi kompjuterike (CT)  Jo  Po .....

Radiografi e enëve të gjakut  
(Angiografi / Kateteter kardiak)  Jo  Po .....

Radiografi e veshkave (Urografi)  Jo  Po .....

Imazheri e venave të këmbës (Flebografi)  Jo  Po .....

**4. A janë shfaqur tek ju efekte anësore pas marrjes së lëndës së kontrastit?**  Jo  Po

Nëse po, cilat? .....

Përzierje / të vjella / ndjesia e mbytjes  Jo  Po .....

Astmë / marrje fryme  Jo  Po .....

Skuqje të lëkurës  Jo  Po .....

Kriza dhimbjesh, humbje ndjenjash  Jo  Po .....

Ethe ngjethëse  Jo  Po .....

**5. A vuani prej njëres nga sëmundjet e mëposhtme?**

Alergji, që kanë nevojë për trajtim?  Jo  Po .....

të zemrës  Jo  Po .....

të veshkave / të gjëndrave mbiveshkore  Jo  Po .....

të gjëndrave tiroide  Jo  Po .....


Sëmundjes së sheqerit (diabetit)  Jo  Po .....

Nëse po, cilat ilaçe merrni ju për diabetin? .....

Myasthenia gravis? (Sëmundje muskujsh e veçantë)  Jo  Po .....

**6. A keni ju një pace-maker?**  
**(Relevante vetëm në ekzaminimet TK të toraksit)**  Jo  Po Prodhimi: .....

Me anë të nënshkrimit tim, unë vërtetoj se e kam lexuar dhe kuptuar tekstin e këtij formulari. Unë u jam përgjigjur pyetjeve sipas dijenive të mia më të mira. Në bisedën personale, më janë shpjeguar rreziqet e mundshme dhe më janë dhënë përgjigje të mjaftueshme për pyetjet e mia të mëtejshme. Unë jam dakord, që ekzaminimi i propozuar të kryhet.

	Nënshkrimi i pacientes/pacientit dhe/ose i përfaqësuesit ligjor	Nënshkrimi i mjekes/mjekut
Data / ora	Emri dhe nënshkrimi i MTD	

Ne ju lutemi që këtë formular t'ia dorëzoni stafit profesional teknik mjekësor që është duke j'u trajtuar, përpara ekzaminimit tuaj.

Shënime mjekësore mbi bisedën shpjeguese		
Pacientja/pacienti është dakord për kryerjen e ekzaminimit	Po <input type="checkbox"/>	Jo <input type="checkbox"/>

Në rastin e refuzimit të ekzaminimit, pacientja/pacienti është informuar mbi disavantazhet e mundshme që rrjedhin prej tij.